Perjashtimisht subjektet ekonomike do të tarifohen sipas raportit të inspektionit për veprimtarit: Shërbime juridike 700€, Avokatura 700€, Noterët 700€, Përmbarusit 700€, dhe Ndermjetesues 700€,Posta 1000€ dhe shërbimet tjera postare 300€,Ordinancat tjera shendetsore 360€.

13.2.1. Çdo biznes në vitin e parë të themelimit/regjistrimit të saj, pa marrë parasysh datën e regjistrim/themelimit, lirohet nga pagesa e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

13.2.2. Bizneset ekzistuese dhe ato fillestare që ushtrojnë veprimtaritë e tyre nga sektori A lirohen nga taksa në afat të pa caktuar.

13.2.3. Lirohen nga taksa komunale për ushtrimi e veprimtarisë së tyre Bashkësit fetare, ndërmarrjet publike komunale, Organizatat joqeveritare (ojq) për ushtrimin e aktivitetit ekonomik me qëllim mbështetjes së aktiviteteve jo fitimprurëse, ndërsa OJQ-të mikrofinanciare do të taksohen në vlerë prej 1000.00 € (një mijë euro).

13.2.4. Shoqërit tregëtare që gjatë vitit fiskal kanë qenë pasive dhe nuk kanë ushtruar veprimtari, lirohen me prezantimin e dëshmisë/dokumentacionit të lëshuar nga ATK-së për vitin fiskal (deklaratat vjetore) pas kërkesës së parashiturar komisionit komunal për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave ndaj taksës.

13.2.5. Bizneset të cilat shuhet lirohen nga pagesa e taksës për vitin fiskal në të cilin shuhet (lirohen për ata muaj të operimit brenda vitit fiskal). Prezantimit të dokumentacionit zyrtar të shuarjes së biznesit ose informimit zyrtari i caktuar për regjistrim të bizneseve në ARBK.

13.2.6. Drejtorati për zhvillim Ekonomik shpërndarjen e faturave dhe aktvendimeve do të bëjë brenda vitit fiskal.

13.2.7. Subjektet ekonomike tarifën e caktuar sipas nenit 13 të kësaj rregullore do ta paguajnë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së bashku me vërtetjen.

13.2.8. Subjektet faturën e pranuar brenda 30 ditësh mund ta kontestojnë me anë të ankesës drejtuar Komisionit për komunal për ankesa dhe kërkesa ndaj taksës komunale.

13.2.9. Perjashtim nga pika 13.2.7 do të bëjnë subjektet ekonomike të cilat parshtrajnë kërkesë për pezullim të përkohëshëm të procedurës së inkasimit pas prezantimit të deklarimeve 3 mujore nga ATK për mos ushtrim të veprimtarisë. Procedura e inkasimit për bizneset në fjalë pezullohet përkohësisht deri në deklaratat vjetore sipas nenit 13.2.4 drejtuar komisionit komunal për ankesa dhe kërkesa ndaj taksës komunale.

13.02.10. Shqyrtimin e lëndëve sipas pikës 13.02.04 si dhe ankesave kundër aktvendimeve të caktimit të taksës për ushtrimin e veprimtarive biznesore do ta bëjë komisioni komunal për ankesa dhe kërkesa ndaj taksës komunale i caktuar prej 3/5 anëtarëve në mandat 3 deri 5 vjeçar.

13.2.11. Në raste që bizneset nuk marrin faturat/aktvendimin, ato janë të obliguara të interesohen për obligimet e tyre që i kanë ndaj komunës, pra që të vizitojnë zyrën e Drejtoratit për Zhvillim Ekonomik pranë Komunës së Drenasit.

13.2.12. Subjektet të cilat nuk kryejn obligimet e taksës për ushtrimin e veprimtarisë biznesore lëndet e tyre do të procedohen për inkasim të dhunëshëm përmes procedurës përmbartimore dhe dispozitave tjera ligjore.

13.2.13. Bizneset të cilat bëjnë ndrrimin e tipit të biznesit taksa e tipit të biznesit paraparak bartet tek tipi i ri i biznesit.

13.2.14.. Bizneset do të ngarkohen sipas kësaj rregullore duke filluar nga janari i vitit 2024

Neni 14

Përgjegjëse: Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Nr. i Tarifës dhe ngarkesës	Shërbimet	Vlera vjetore në euro
--------------------------------------	-----------	-----------------------------

	Shërbimet	
	Taksat për leje operimi	
	Leje për bllokim të rrugës (shiriti rrugor – trotuarit)	Shuma €
14.1	Zona urbane 12 - orë	20
14.2	Zona urbane 24 - orë	25
14.3	Leje për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallrave në rrugë dhe trotuar, në afërsi të lokaleve afariste, për një ditë	3
14.4	Leje për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallrave në rrugë dhe trotuar, në, në afërsi të lokaleve afariste për 1 muaj	10
14.5	Leje për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallrave në rrugë dhe trotuar, në, në afërsi të lokaleve afariste për 1 vit	50

14.5.1	Leje për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallarave në stacionin e autobusëve, në afërsi të lokaleve afariste, për 1 dite	1
14.5.2	Leje për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallarave në stacionin e autobusëve, në afërsi të lokaleve afariste, për 1 muaj	5
14.5.3	Leje për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallarave në stacionin e autobusëve, në afërsi të lokaleve afariste, për 1 vit	25
14.6	Leje operimi për auto taksi 4+1 ulëse, për 1 vit	25
14.7	Leje operimi për kombi-bus 8+1 ulëse (Leje e veçanet për transportin e nxënësve të mësimi fillor, atyre me nevoja të veçanta dhe personave që barten për hemodializ), për 1 vit	25
14.8	Ndërrimi i aktvendimit për leje të operimit për auto-taksi (nënkuptohe kur nga pronari ndërrohet automjeti para skadimit të lejes që është pajisur më pare)	15
14.9	Vërtetimi i rendit të udhëtimit për linjën e rregullt të udhëtarëve dhe për transport të veçante, operatori transportues paguan taksën për një vit (për një relacion- nisje të caktuar)	15
14.10	Pëlqim për dhënien e lejes për vend-parkimin e automjeteve transportuese për mallra, zhavor, dru (Autoparku) /për një vit	150
	Leje për automjetet e renda transportuese me peshë prej (3.5-7.5)ton, të cilat kanë nevojë për qarkullim në ato rrugë(qendrës së qytetit) ku me shenjë të komunikacionit e kanë të ndalur	
14.11	Leje e lëshuar për 1 deri në 3 ditë	5
14.12	Leje e lëshuar për 1 deri në 15 ditë	15
14.13	Leje e lëshuar për 1 muaj	25
14.14	Leje e lëshuar vjetore të cilat rrugë shfrytëzohen herë pas here	100

14.15 Parkingjet e rezervuara në hapësirën Publike- parkingje për një vit

- Zona e parë 100 €
- Zona e dytë 50 €
- Zona e tretë..... 20 €

14.16 Parkingu kohor për një ditë

- Zona e parë 0.90 €
- Zona e dytë 0.40 €

- Zona e tretë 0.20 €
Nga kjo takes lirohen persona më aftësi të kufizuara dhe Shoqatat e luftës.

14.17. Taksat dhe ngarkesat për transport TAKSI

- Transporti auto-taksi i udhëtareve pa licencë500 €
- Tarifa për ndrrimin e çip kartelave, për hyrje dalje në parkingjet me laura automatike për një vit 10 €
- Tarifa për çip kartela, për hyrje dalje në parkingjet më laura automatike për biznese e cila shërben vetëm për kohën e caktuar prej (10-20)min, për ngarkim shkarkim të mallit, për një vit 20 €
- Operatorët taksi që ndërprejnë veprimtarinë dhe nuk e kthejnë lejen e operimit200 €
- Operatorët taksi që nuk i kanë automjetet në gjendje sipas kushteve teknike300 €
- Automjetet që nuk respektojnë rendin e ardhjes dhe vozitjes200 €
- Autotaksi që nuk e vendosin lejen për ushtrimin e veprimtarisë në mënyrë të dukshme.....100 €
- Autotaksit që bëjnë bartjen:
 - Fëmijëve nën moshën 6 vjeçare pa praninë e prindit
 - Bartin kafshë të ngordhura
 - Kufoma
 - Material eksplozive (piroteknike) 500

14.18 Taksat për dhënien me qira të tregut të gjelbër (sipërfaqja e përgjithshme e tregut)

Zona I.....	1.0 €/m ² për vit
Zona II	0.70 €/m ² për vit
Zona III.....	0.5 €/m ² për vit

Kafshëve

Zona I.....	0.50 €/m ² për vit
Zona II	0.30 €/m ² për vit
Zona III.....	0.20 €/m ² për vit

4.19 Taksat për hyrje në tregun e Gjellbër.

Për kamion 3.5 t	5 € në ditë
Për kamion 5t	7 € në ditë
Për kamion 7.5 t	8 € në ditë

14.20 Taksat për hyrje në tregun e Kafshëve

Hyrja:

Për copë në ditë për kafshë të trasha.....	2 €
Për kafshë të imta në ditë	0.40 €

14.20.1 Tarifa për matjen e kafshëve në peshoren e tregut të kafshëve:

Për kafshë të trasha 2€ për copë

Për kafshë të imëta 0.50 € për copë

14.20.2 Tarifa për shfrytëzim të shtyllave metalike të ndriçimit publik nga kompanitë e telekomit, internetit etj. është 2€ në vit për shtyllë të ndriçimit.

14.20.3 Tarifa për një hyrje/dalje në Stacionin e Autobusëve nga Operatorët për Transport të Udhëtareve është 2€

14.20.4 Tarifa e parkingut për autobus në stacionin e autobusëve jashtë orarit të punës është 2 €.

14.20.5. Tarifa për shërbime të mbeturinave të amvisërisë është 4.70 €.

14.20.6. Tarifa për shërbime të mbeturinave në institucione komunale. Llogaritet për një zbrazje të kontejnereve 1.1.m3 të amvisërisë është.....1 zbrabzje/10.5 €.

14.20.7. Tarifa për shërbime të mbeturinave ndërtimore në deponin inerte e cila llogritet për ton 1t/1 €.

14.21 PËR HAPËSIRËN NË TË CILËN VENDOSEN REKLAMAT, PANOTË, KOMPENSIMI PAGUHET SI VIJON:

- Për reklama, pano ndriçuese që tregojnë ku është vendosur lokali afarist, ngarkesa për një vit është -

Zona I	50 € m ²
Zona II	30 € m ²

Zona III 15 € m²

- Për reklama, pano pa ndriçim dhe lajmërimi që tregojnë vendin ku është vendosur lokali afarist, ngarkesa për një vit është -

Zona I 25 € m²

Zona II 15 € m²

Zona III 10 € m²

- Për hapësirën që shfrytëzohet për lojërat e cirkut, lojërave argëtuese etj. Ngarkesa është ditore edhe është..... 0.50 € m²

- Toka që shfrytëzohet për të vendosur të gjitha llojet e aparateve, (akullore) për aparat në vit

Zona I 70 €

Zona II 30 €

Zona III 10 €

14.22 Veprimtaritë për të cilat kërkohet leje mjedisore komunale (UA MMPH 01/2017)

Të gjitha veprimtaritë për të cilat kërkohet Leje mjedisore komunale janë në shtojcën 1 të këtij udhëzimi.

Tarifa për tu pajisur me leje Mjedisore komunale paguhet taksa:

- Në vlerën investive të projektit deri në shumën 25,000 euro paguhet tarifa në vlerë prej:.....50 €

- Në vlerën e investimeve të projektit mbi 25,000 euro paguhet tarifa 0.2% të vlerës investive të projektit.

Të liruar nga pagesa e kësaj tarife janë projektet publike.

Neni 15

Përgjegjëse: Drejtorati për Buxhet dhe Financa

15.1. Ngarkesa për lejen e pronësisë së automjetit, parkimin dhe tërheqjen e automjetit

Të gjithë banorët dhe bizneset, kërkohet të marrin leje për pronësinë e automjetit Brenda kufijve të Komunës së Drenasit.

Për sigurimin e këtyre lejeve për automjete të bizneseve apo banorëve duhet të sigurohen dëshmi mbi regjistrimin e automjetit nga autoriteti qendror i Kosovës dhe adresën e shtëpisë ose selinë e biznesit të regjistruar pranë MTI-së.

Tarifat për lëshimin e lejes do të paguhet në Komunë në bazë vjetore.

Këto tarifa do të jenë si vijon:

a) Për automjete dhe taksi:

Benzinë – naftë

Deri në 3000 ccm	10 €
Nga 3000 – 3500 ccm	15 €
Mbi 3501	20 €

b) Për Kamion që bëjnë transportin e mallrave:

Benzinë – naftë

Deri në 3.5 t	20 €
---------------	------

c) Për autobus

Për autobusë	30 €
--------------	------

15.2 Nga tarifa për leje për mjete motorike lirohen të gjitha automjetet në pronësi të komunës, KFOR-it, UNMIK-ut, EULEX-it përfaqësive diplomatike, emergjencës (makinat e zjarrfikësve dhe ato të ndihmës së shpejt). Provë për këtë është leja e qarkullimit të automjetit.

Për aplikimin e kësaj pjese (4,5) të tarifave përgjegjëse është Drejtoria për Buxhet dhe financa.

Neni 16

Implementues: Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

16. Ngarkesat për dhënien në përdorim të pronës komunale

Para se të aplikohet tarifa e ngarkesave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, në radhë të parë do të vlejë vlera e tregut e më pas do të aplikohet tarifa siç vijon:

Drenasi do të ndahet në dy zona: Zona Urbane dhe Zona jashtë kufirit urban me Pzhk.

16.1 Qëraja për shfrytëzim të përkohshëm:

a) Qiraja për tokën e dhënë në shfrytëzim të përkohshëm, tarifa mujore..... 2,50 €/m²

b) Qiraja për tokën e dhënë në shfrytëzim të përkohshëm (më pak se një vit) për ngritjen e objektit të përkohshëm për qëllim të afarizmit, tarifa mujore **5.00 €/m²**

c) Qiraja për dhënien e tokës në shfrytëzim për ndërtimin e ndërtesave individuale, tarifa mujore **0,15 €/m²**

d) Qiraja për dhënien në shfrytëzim të objektit për banim – pronë komunale, tarifa mujore **2.00€/m²**

e) Qiraja për dhënien e lokalit afarist-komercial, dhe objekteve tjera si depo etj, pronë komunale, tarifa mujore..... **6,00 €/m²**

Zona e I-rë

f) Qiraja për dhënien e lokalit afaristo-komercial, dhe objekteve tjera si depo etj, pronë komunale, tarifa mujore **4,00 €/m²**

Zona II-të

16.2 Ndërtimi i antenave, TV, PTK, kabllave dhe të ngjashme, paguhet:

Zona e I-rë..... **1000.00 €**

Zona e II-të **500.00 €**

16.3 Vendorsja e kioskave dhe objekteve të tjera montuese, në të cilat kryhet kryesisht veprimtaria tregtare, tarifat mujore sipas zonave janë:

Zona e I-rë **5.00 € m²**

Zona e II-të..... **4.00 € m²**

16.4 Vendorsja e Panove në pronën publike

Zona e I-rë **50 € m²/vjetore për një pano,**

Zona e II-të **35 € m²/vjetore për një pano dhe**

16.5 Vendorsja e tendave të hapura dhe lëvizëse për shitjen e librave jo shkollore, tarifat mujore sipas zonave:

Zona e I-rë..... **15.00 €**

Zona e II-të **10.00 €**

16.6 Vendorsja e kabinave telefonike:Tarifa mujore për kabina50.00 €

16.7 Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e automjetit levizës për shitjen e ushqimit të shpejtë, tarifa mujore..... 20.00 €/ m²

16.8 Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e tendave (qadrave) të hapura lëvizëse me mekanizëm, tarifa mujore për tendë 10 € m²

16.9 Shfrytëzimi i hapësirave publike për vendosjen e lojërave të fëmijëve, tarifa mujore 2.50 €/m²

16.10 Shfrytëzimi i hapësirës publike – ekspozimi dhe deponimi i mallit, ambalazhi, tarifat mujore sipas zonave është:

Zona e I-rë.....	4.00 €/m ²
Zona e II-të.....	2.50 €/m ²

16.11 Ndalohet reklamimi i pijeve alkoolike dhe duhanit përmes panove reklamuese.

Pagesat e taksave dhe ngarkesave të tjera dhe lejeve të ndërtimit

16.12 Kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore në bazë të kësaj Rregulloreje paraqet shpenzimet mesatare të rregullimit të marra në bazë të llogarisë mesatare të ndërtimit të objekteve të infrastrukturës dhe përshtatshmërisë për lokacionin përkatës.

16.13 Kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore bëhet me rastin e ndërtimit të objektit, zgjerimit të objektit ekzistues, mbindërtim, shëndrrimit të objekteve banesore në ato afariste qofshin ato të përkohshme apo të përhershme.

16.14 Lartësia e kompenzimit për rregullimin e tokës ndërtimore bazohet dhe llogaritet për m² të sipërfaqes shfrytëzuese për ndërtim.

16.15 Kryefamiljarët e familjeve të ngushta të Dëshmorëve të UÇK-së dhe invalidëve të UÇK-së lirohen nga pagesa e taksës komunale për marrjen e lejes ndërtimore për ndërtim të objektit banesor individual.

16.16 Ndërtimi i objekteve me destinim banimi dhe afarizëm (vendimi 12-Nr.400-36757 të datës 04.07.2017)

- Taksa administrative për leje ndërtimi 1.30 €/m²
- Tarifa e densitetit 132.30 €

16.17 Shfrytëzimi i hapësirave publike para lokaleve (vendimi 12-Nr.400-36766 të datës 04.07.2017)

Drenasi do të ndahet në dy zona: Zona Urbane dhe Zona jashtë kufirit urban me Pzhk.

Zona I-rë sipas Pzhk-së- “Zona Urbane”

- Zona I-rë sipërfaqe e mbyllur 3.00€/m²/mujore
- Zona I-rë sipërfaqe e hapur..... 1.00€/m²/mujore

Shfrytëzimi i hapësirave publike para lokaleve jashtë zonave urbane, Zona II:

- Sipërfaqja e mbyllur 2.50 €/m²/mujore
- Sipërfaqja e hapur 1.00€/m²/mujore

16.18 Për shëndërrimin e objekteve banesore në objekte afariste dhe anasjelltas.

- Zona e I-rë 35.00 €/m²

- Zona e II-të20.00 €/m²
- 16.19 Pagesa për qiranë e banesave për sipërfaqet e përbashkëta të llogaritet në m² të banesës dhe atë 0.05 €/m²
- 16.20 Për peisazhe në objekt ndërtimor nuk llogaritet taksa por kërkohet leje e posaçme.
- 16.21 Nëse paraqet investitori kërkesë për rrënim për objektin i cili ka poseduar leje aty i zbriten pagesa e rentës për atë sipërfaqe të lejes paraprake.
- 16.22 Sipas kësaj Rregulloreje do të lirohen nga pagesa e taksës për rregullimin e tokës ndërtimore, institucionet qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës në interes të përgjithshëm, objektet e karakterit fetar, arsimor, kulturor, shëndetësor, mbrojtjes sociale, të cilat nuk kanë karakter biznesi etj. dhe qëllimeve humanitare.
- 16.23 Po ashtu do të lirohen nga pagesa e taksës për rregullimin e tokës ndërtimore objektet që ndërtohen për nevoja të KFOR-it, FSK-së, Policisë.
- 16.24 Do të lirohen nga kompenzimi dhe objektet e dëmtuara nga lufta të cilat kanë pasur leje të ndërtimit për sipërfaqen e objektit të dëmtuar po që se investitor është i njëjti pronar dhe objekti ndërtohet në të njëjtën parcelë kadastrale.
- 16.25 Të gjithë personat fizik apo juridik, kompenzimin e tokës ndërtimore e bëjnë para marrjes së lejes ndërtimore po që se nuk është rregulluar ndryshe me ndonjë akt të veçantë.
- 16.26 Mjetet e inkasuara nga kompenzimi për rregullimin e tokës ndërtimore nuk mund të përdoren për qëllime të tjera përveç se për rregullimin e tokës ndërtimore në Komunën e Drenasit.

Neni 17

Përgjegjës: Drejtorati për Infrastruktur Lokale.

17.1. Tarifa sipas gjatësisë përë metër gjatësi;

- 17.21.1. Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore (ujësjellës, kanalizim fekal dhe atmosferik).....1.00 €/m;
- 17.1.2. Shtrirja e gypave për ngrohje..... 1.00 €/m;
- 17.1.3. Shtrirja e rrjetit kabllor, PTK, TV, KEDS 1.00 €/m;
- 17.1.4. Prerja e Asfaltit 50.00 €/m
- 17.2. Qiraja vjetore për operatorete të cilet shfrytzojnë gypat e vendosur në rrugë për shtrirjen e kabllave oprike..... 0.10€/m

Neni 18

Përgjegjës: Drejtorati për Inspektion.

18. Tarifat Inspektuese:

18.1 Tarifa inspektuese për kafshë të trasha, si p.sh. lopë, kuaj etj..... 5.00 €

18.2 Tarifa inspektuese për kafshë të imëta si p.sh. delet, dhitë, qentë, macet, etj..... 1.00 €

18.3 Vërtetimi i lëshuar për kafshë të imëta nga stacioni i veterinars..... 1.00 €

18.4 Mjetet e mbledhura nga pika 19.1 deri në 19.2 i takojnë veterinars 50%

Pranimi teknik i lokaleve afariste

18.5 Tarifa për lokalin deri në 30 m² 30 €

18.6 Tarifa për çdo meter katror mbi 30 m² deri në 500 m² 0.50 €

18.7 Tarifa mbi 500 m² 0.30 €

18.8. Tarifa për dhënjën e pëlqimit për kushte minimale teknike për ushtrimin e veprimtarisë

18.8.1. Pëlqimi për kushtet minimale teknike për ushtrim të veprimtarisë në lokalet deri 100m².....20 €

18.8.2. Pëlqimi për kushtet minimale teknike për ushtrim të veprimtarisë në lokalet mbi 100m² deri 450m²..... 0.30 euro për m².

18.8.3. Pëlqimi për kushtet minimale teknike për ushtrim të veprimtarisë në lokalet mbi 450m² deri 450m²..... 0.40 euro për m².

Inspektimi për mbrojtjen e kushteve higjeniko-sanitare

18.9 Tarifa për Inspektimi për plotsimin e kushteve higjeniko – sanitare 5 €

18.10	Kyçja pa leje në rrjetin e ujësjellësit	
18.10.1	Person Fizik	300
18.10.2	Person Juridik	500
18.11	Kyçja pa leje në rrjetin e kanalizimit publik	

18.11.1	Person Fizik	300
18.11.2	Person Juridik	500
18.12	Derdhja e Ujërave të zeza në hapësirat publike	
18.12.1	Person Fizik	300
18.12.2	Person Juridik	500
18.13	Gjjobat për hedhjen e mbeturinave (UA 06/2018)	
18.13.1	Hedhja e cigares në rrugë, çamçakëzit etj.	20
18.13.2	Hedhja e ambalazheve dhe mbeturinave (qelq, letër, kanaçe, mbeturinave ushqimore etj.) në sipërfaqe publike	30
18.13.3	Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerit, shkapërderdhja etj.	40
18.13.4	Hedhja e mbeturinave nga automjeti	50
18.13.5	Hedhja e mbeturinave nga ballkoni, në puseta, kanalizime, ngjyra etj.	70
18.14	Hedhja e mbeturinave jashtë vendeve të përcaktuara të të gjitha natyrave të mbeturinave	
18.14.1	Person Fizik	90
18.14.2	Person Juridik	2500-5000
18.15	Hedhja e çfarëdo mbeturine në përroskat e lumenjve, liqeneve, kanalizimeve apo të tjera	
18.15.1	Person Fizik	100
18.15.2	Person Juridik	2500-5000
18.16	Për keqpërdorim të ujit të pijshëm	

18.16.1	Person Fizik	50
18.16.2	Person Juridik	100
18.17	Dëmtimi i çfarëdo forme i objekteve me interes të përgjithshëm siç janë: Ndriçimi publik, shenjat e komunikacionit, shenjat e emërimit të rrugëve etj.	
18.17.1	Dëmtimi i shtyllës ndriçuese	350
18.17.2	Dëmtimi i bimëve dekorative nëpër parqe	100
18.17.3	Dëmtimi i ulëseve dhe pjesëve përcjellëse të parqeve (ndotja, thyerja dhe dëmtime të tjera)	100-500
18.17.4	Dëmtimi i rrethojave për mbrojtjen e gjelbërimit për metër gjatësi	100
18.17.5	Dëmtimi i shenjave të komunikacionit dhe shenjave të emërimit të rrugëve	100 - 500
18.17.6	Kalimi në këmbë në sipërfaqe të gjelbëruara	50
18.17.7	Kalimi në sipërfaqe të gjelbëruara dhe hapësira të tjera të ndaluara publike me automjet	200
18.18	Larja e veturave dhe automjeteve të tjera në trotuare dhe rrugë	
18.18.1	Person Fizik	20
18.18.2	Person Juridik	100
18.19	Gjjobat për çfarëdo lloje dëmtimi të kamerave	
18.19.1	Person Fizik	300
18.19.2	Person Juridik	1000
18.20	Operatori juridik që nuk i plotëson kriteret:	
18.20.1	- Nuk ka të regjistruar këtë lloje të transportit;	100-500
18.20.2	- Nuk e ka selinë e transportit ku vepron;	200

18.20.3	- nuk ka vendqëndrim për automjet	500
18.21	Dëmtimi i pritoreve (kabinave) e stacioneve	
18.21.1	Person Fizik	300
18.21.2	Person Juridik	500

Neni 19

Përgjegjës: Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport

PALESTRA SPORTIVE “Hysni Jetullahu”:

Nr.	Qëllimi i shfrytëzimit	sezoni	Ora		Shuma në euro
19.1	Stërvitje 60 min. Për shkollat sportive publike –private	veror	08 ⁰⁰ -13 ⁰⁰		8,00
			13 ⁰⁰ -18 ⁰⁰		10,00
	Me ndriçim				12,00
19.2	Stërvitje 60 min. Për shkollat sportive publike –private	dimëror	Prej 13 ⁰⁰		15,00
	Me ndriçim				15,00
19.3	Stërvitje 60 min. Për klube sportive publike	veror	08 ⁰⁰ -13 ⁰⁰		10,00
			13 ⁰⁰ -18 ⁰⁰		12,00
	Me ndriçim				17,00
19.4	Stërvitje 60 min. Për klube sportive publike	dimëror	Prej 13 ⁰⁰		20,00
	Me ndriçim				20,00
19.5	Ndeshje sportive me bileta deri 400 shikues	Meshkuj-verore			80,00
		dimërore			100,00
19.6	Ndeshje sportive me bileta deri 400 shikues	femra-verore			60,00
		dimërore			80,00
19.7	Ndeshje sportive me bileta mbi 400 shikues				20% nga shitja e biletave
19.8	Stërvitje 60 min. Për klube sportive private Pa ndriçim	verore			15,00

	Me ndriçim				20,00
19.9	Stërvitje 60 min. Për klube sportive private Me ndriçim	dimëror			25,00
19.10	Turnire finalja dhe gjysëmfinalja plus 30% nga shitja e biletave		1 orë		10,00 30%
19.11	Ngjarje kulturore -koncerte	verore	1 orë		300,00
		dimërore	1 orë		350,00
19.12	Tubime dhe organizime të ndryshme-pa zërim dhe dekor		60 min.		100,00
			paushall		250,00
	Tubime dhe organizime të ndryshme-me zërim.		60 min		150,00
			paushall		300,00
19.13	Vendosja e reklamave për një muaj				
	-Në qendrën e fushës së basketbollit-në parket				150,00
	-Në gjysëmrrrethin e reketit të fushës së basketbollit				60,00
	-Në hapësirën e gjashtëmetërshit të fushës(2x0.60m)				60,00
	-Në hapësirën brenda fushës (2x0,60m)				60,00
	-Rreth vijave të fushës (3x0,60m)				60,00
	-Në vijën anësore lindje dhe përendim (2 x 0,80)				60,00
	-Në pjesët tjera të Palestrës (2 x 0,60m)				30,00

Për shkollat sportive publike –private të cilat janë të regjistruara dhe veprojnë në komunën e Drenasit tarifat janë 70 % më lirë se sa janë në pikat 19.1 dhe 19.2.

Nga këto tarifa lirohen:

- Klubet sportive të regjistruara pranë Federatave të Sporteve përkatëse dhe DKRS-ës dhe veprojnë në komunën e Drenasit.
- Shoqatat e dala nga lufta
- OJQ-të e personave me nevoja të veçanta

STADIUMI SINTETIK I FUTBOLLIT:

Nr.	Qëllimi i shfrytëzimit	kategoria	koha	Ora	Shuma në euro
19.14	Shkollat e regjistruara të futbollit	Parafatosat	60 min		30,00

		Fatosat	60 min		60,00
		Pionerët	60 min		60,00
		Kadetët	60 min		60,00
		Juniorët	60 min		60,00
		Senjoret	60 min		60,00
	Ndeshje sportive		90 min		150,00

Për shkollat sportive publike –private të cilat janë të regjistruara dhe veprojnë në komunën e Drenasit tarifat janë 80 % më lirë se sa janë të përcaktuara në pikën 19.14.

Nga këto tarifa lirohen:

- Klubet sportive të regjistruara pranë Federatave të Sporteve përkatëse dhe DKRS-ës, dhe veprojnë në komunën e Drenasit.
- Shoqatat e dala nga lufta
- OJQ-të e personave me nevoja të veçanta

STADIUMI I FUTBOLLIT “REXHEP REXHEPI”

Nr.	Qëllimi i shfrytëzimit	koha		Shuma në euro
19.15	Ndeshje sportive	90 min		800,00
	Ushtrime	90 min		250,00

SALLA E KULTURËS-KINO SALLA

Nr.	Qëllimi i shfrytëzimit	Shuma në euro
19.16	Shfaqje - me zërim	30% nga shuma e përgjithshme
	- pa zërim	20% nga shuma e përgjithshme
19.17	Shfrytëzimi i sallës për tubime, promovime të ndryshme pa zërim	150,00
19.18	Shfrytëzimi i sallës për tubime, promovime të ndryshme me zërim	200,00
19.19	Shfrytëzimi i sallës për tubime, promovime të ndryshme me zërim për qëllime humanitare, nevojave të institucioneve vartëse të Komunës dhe bashkëorganizimeve të Komunës me subjektet të tjera.	Pa pagesë

19.20	Sanksionimi- nese estrada, grupi muzikor nuk i përmbahet lajmërimit	10% nga shuma e përgjithshme
-------	---	------------------------------

Neni 20

Përgjegjës: Drejtorati për Arsim

Tarifat në sferën e arsimit

Nr	Përshkrimi i tarifave – ngarkesave, kompensimeve dhe taksave për shërbime	Çmimorja
20.1	Tarifa mujore për një fëmijë në qerdhe QEAP Ardhmeria Gllogoc	35 €
20.2	Tarifa mujore për një fëmijë QEAP Ardhmeria në Komoran	35 €
20.3	Tarifa mujore për dy fëmijë, i pari 35 € dhe i dyti 20 €	55.00 €
20.4	Tarifa mujore për tre fëmijë në qerdhe (i pari tarifen e plot i dyti 20€, i treti 10€) nga tarifa e plotë mujore	65 €
20.5	Tarifa mujore për fëmijë të puntorëve në qerdhe paguhet 70 % nga tarifa e plotë	24.50 €
20.6	Tarifa për regjistrimin e vitit shkollor për arsimin dhe aftësimin profesional	100 €
20.7	Tarifa për provimin përfundimtarë Çertifikata/diplomën për arsimin dhe aftësimin profesional	50€
20.8	Tarifa për praktikë profesionale	50 €
20.9	Tarif për provimet diferenciale për arsimin dhe aftësimin profesional	10 €
20.10	Tarifat për dokumente duplikat për shkollat e mesme për çdo dokument paguhet	1 €

Neni 21

Implementues: Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Shojca 1-a- Çmimorja e bashkëpagesave për shërbimet shëndetësor të nivelit parësor në QKMF

Sipas Udhëzimit Administrativ 04/2007, për Mblidhjen dhe shfrytëzimin e mjeteve nga bashkëpagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetanake të institucioneve shëndetësore.

Nr.	Emertimi i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime	Euro (€)
-----	---	----------

21.1	Ekzaminimi mjekësor në punkt, QMF ose QKMF, pa analiza laboratorike, ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë	1.00
21.2	Ekzaminimi mjekësor në QMF/QKMF me udhëzim të mjekut familjar	2.00
21.3	Ekzaminimi mjekësor në QMF/QKMF pa udhëzim të mjekut familjar	5.00
21.4	Ekzaminimi në shtëpi, përveç në rastet emergjente	6.00
21.5	Medikamenti nga Lista esenciale, ofruar në barnatoren publike	0.30
21.6	Ultrazëri standard	2.00
21.7	Radiografia	2.00
21.8	EKG-ja	0.50
21.9	Analizat laboratorike, vetëm hemogrami dhe urina	1.00
21.10	Analizat laboratorike (komplet) biokimike (5 parametra)	3.00
21.11	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	1.0
21.12	Shpërlarja e veshit	1.00
21.13	Dhënja e injeksionit intramuskular në shtëpi, përveç në raste emergjente	1.00
21.14	Dhënja e injeksionit intravenoz në shtëpi, përveç në rastet emergjente	1.00
21.15	Dhënja e infuzionit	1.00
21.16	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërimin e plagës (vetëm në vizitën e parë)	3.00
21.17	Trajtimi ditë me infuzione në institucionin shëndetësor	1.00
21.18	Dhënja e Raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	5.00
21.19	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive, etj,një orë	25.00
21.20	Shtetasit e huaj dhe bartësit e sigurimeve të huaja shëndetësore do të paguajnë shërbimet e ofruara pesë herë më shtrenjtë se sa shtetasit e Republikës së Kosovës, për një shërbim që ka bashkëpagesë në lartësi prej 2€, shtetasi i huaj ose bartësi i sigurimit të huaj shëndetësor do të paguaj 10€	5.00
21.21	Audiograma	1.00

Shtojca Nr.1:” Çmimet për Certifikata shëndetësore”

Sipas Udhëzimit Administrativ (shëndetësi), nr.04/2013, Certifikatat Shëndetësore.

<i>Nr.</i>	<i>Lloji i Certifikatës</i>	<i>Çmimi</i>
21.22	Certifikata shëndetësore për edukim dhe shkollim	Certifikata për regjistrimin në çerdhe ose kopshte fëmijësh 10 Euro Lirohen nga pagesa në sektorin

		Certifikata shëndetësore për regjistrim në shkolla fillore, të mesme, të larta, fakultete dhe nivele të tjera të shkollimit	publik bazuar në Ligjin për shëndetësi. Përfshihen moshat mbi 26 vjet dhe shtetasit e huaj.
		Certifikata shëndetësore për regjistrim në shkolla të veçanta të të gjitha niveleve dhe shkolla të tjera, për profesione të veçanta	
21.23	Certifikata shëndetësore për punësim	Certifikata shëndetësore për punësim	15 Euro
		Certifikata shëndetësore për punësim në vende me kushte të veçanta pune	50 Euro
		Certifikata shëndetësore për punë profesionale në lëmin e komunikacionit	50 Euro
21.24	Certifikata shëndetësore për për paisje me patentë shofer	Certifikata shëndetësore për pajisje me patentë shoferi për kategoritë A1, A, B1, B, BE, M, L dhe T	20 Euro
		Certifikata shëndetësore për pajisje me patentë shoferi për kategoritë C1, C, D1, D, C1E, CE, D1E dhe DE	50 Euro
21.25	Certifikata shëndetësore për vlerësimin e aftësive psiko-fizike të përgjithshme dhe të veçanta		50 Euro
21.26	Certifikata shëndetësore për përcaktimin e zotësisë së veprimit		50 Euro
21.27	Certifikata shëndetësore për përcaktimin e shkallës së lëndimeve trupore dhe /ose psikike		50 Euro

21.28	Certifikata/libreza shëndetësore për vlerësimin e aftësive psiko-fizike të sportistëve		10 Euro Lirohen nga pagesa në sektorin publik bazuar në Ligjin për shëndetësi. Përfshihen moshat mbi 26 vjet dhe shtetasit e huaj.
	Libreza shëndetësore për sportistë profesional		20 Euro
21.29	Certifikata shëndetësore për aftësinë psiko-fizike të bashkëshortëve për adoptim të fëmijës		50 Euro
21.30	Certifikata shëndetësore për aftësinë shëndetësore fizike dhe psikike, për paisje me leje për armë		50 Euro
21.31	Certifikata e vdekjes, në rastet kur ka nevojë për autopësi anatomo-patologjike		50 Euro
21.32	Libreza sanitare		15 Euro

Shojca 2-a- Çmimet e bashkëpagesave për shërbimet shëndetësore të nivelit parësor në QKMF

Sipas Udhëzimit Administrativ 04/2007, për Mbledhjen dhe shfrytëzimin e mjeteve nga bashkëpagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetanake të institucioneve shëndetësore.

Nr.	Emërtimi (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)	Euro (€)
21.33	Vizita e parë stomatologjike	1.00
21.34	RTG i dhëmbit	1.50
21.35	Mbushja e përhershme me amalgam	4.00
21.36	Mbushja e përhershme me kompozit	5.00
21.37	Sherimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgam ose kompozitë)	5.00
21.28	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam ose kompozitë)	6.00
21.39	Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam ose kompozitë)	6.00

21.40	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam ose kompozitë)	6.00
21.41	Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam ose kompozitë)	6.00
21.42	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgam ose kompozitë)	6.00
21.43	Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme	6.00
21.44	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	1.00
21.45	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave	1.00
21.46	Vulosja e ficurave	1.00
21.47	Mënjanimi i depozitimeve të buta	1.00
21.48	Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurësve të dhëmbëve me ultratingull	3.00
21.49	Kiretazha e xhepave parodontal (një dhëmbë)	1.00
21.50	Nxjerrja e dhëmbit	1.50
21.51	Incizioni infra dhe ekstra oral	1.50
21.52	Heqja e kurorës me anë të prerjes	1.00
21.53	Riparimi i protezës (ngjitja)	1.50
21.54	Shtetasit e huaj dhe bartësit e sigurimeve të huaja shëndetësore do të paguajnë shërbimet e ofruara pesë herë më shtrenjtë se sa shtetasit e Republikës së Kosovës, për një shërbim që ka bashkë-pagesë në lartësi prej 2€ shtetasi i huaj ose bartësi i sigurimit të huaj shëndetësor do të paguaj 10€	5.00

Çmimorja për tarifat dhe ngarkesat në QPS

Nr.	Emërtimi i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime	Euro (€)
21.55	Vërtetim për zotësi veprimi (armëmbajtje, veprimtari biznesi)	5.00
21.56	Vërtetim lirim nga shtetësia e Kosovës	5.00
21.57	Vërtetim pranim të shtetësisë së Kosovës	2.00
21.58	Mendim profesional – anamnezë sociale	10.00
21.59	Pelqim për martesë para moshës madhore	10.00
21.60	Konkluzë dhe konstatime të ndryshme	5.00
21.61	Pelqim për udhëtim për të mitur- për fëmijë prej 0-18	5.00
21.52	Vertetim që familja nuk është shfrytëzuese e SNS, (nga kjo tarifë lirohen: familjet e deshmorëve, invalidët e luftës, nxënësit dhe studentat)	5.00

Këto çmime janë të kalkuluara në bazë të kostos për njësi, të nxjerrura nga Ministria e Shëndetësisë, me Udhëzimin administrative 6/2006 të cilat janë unike për sektorin e shëndetësisë.

Gjobat nga trafiku

Gjobat e shqiptuara për shkelje kundërvajtjeje në trafik brenda territorit të komunës, janë të hyra vetanake dhe i takojnë Komunës. Transferet bëhen në përputhje me LMFPF-në dhe do t'i përfshijnë pagesat që bëhen përmes Policisë së Kosovës dhe gjykatave, si rezultat i vendimeve gjyqësore.

Gjobat për shkeljen e rregulloreve lokale

Rregulloret lokale, të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Gllogocit, përmbajnë dispozitat ndëshkuese për shkeljen e dispozitave nga bartësit konkretë. Lartësia e gjobës është e bazuar në proporcion me fajësinë e bërë nga shkelësi i dispozitave të rregulloreve komunale, sipas nenit 29, paragrafit 4 dhe 5 të Ligjit nr. 05/L-087 për kundërvajtje.

Neni 22

Dispozitat ndëshkimore

22.1. Me gjobë mandatore në shumë prej 80 euro, inspektori i komunikacionit ndëshkon personin fizik ose juridik, për shkeljen e dispozitave të nenit 14 (par. 14.1; 14.2).

22.2. Me gjobë mandatore në shumë prej 80 euro, inspektori i komunikacionit ndëshkon personin fizik ose juridik, për shkeljen e dispozitave të nenit 14 (par. 14.3; 14.4; 14.5).

22.3. Me gjobë mandatore në shumë prej 50 euro, inspektori i komunikacionit ndëshkon personin fizik ose juridik, për shkeljen e dispozitave të nenit 14 (par. 14.8).

22.4. Me gjobë mandatore në shumë prej 50 euro, inspektori i tregut ndëshkon personin fizik ose juridik, për shkeljen e dispozitave të nenit 14 (par. 14.3; 14.4; 14.5).

22.5. Me gjobë mandatore në shumë prej 100 euro, inspektori i komunikacionit ndëshkon personin fizik ose juridik, për shkeljen e dispozitave të nenit 14 (par. 14.11; 14.12; 14.13; 14.14) për tejkalim të ngarkesës mbi 4ton

22.6. Me gjobë mandatore në shumë prej 100-1000 euro, inspektori i mjedisit ose shërbimeve publike ndëshkon personin fizik ose juridik i cili bënë shfrytëzimin e resurseve natyrore pa pëlqim të autoriteteve kompetente, për shkelje të dispozitave të nenit 10 paragrafi 2 dhe nenit 34 paragrafi 1 të ligjit për mbrojtje të mjedisit 03L-025.

22.7. Me gjobë mandatore në shumë prej 100 euro, inspektori i shërbimeve publike ndëshkon personin fizik ose juridik, për shkeljen e dispozitave të nenit 14 (par. 14.15), përkatësisht personi i cili rezervon në ndonjë mënyrë (me kon, trekëndësh apo në çfarëdo mënyrë) parkingun pa leje nga DSHPE ose nuk e liron parkingun pas skadimit të afatit të kontratës.

22.8. Me gjobë mandatore në shumë prej 1.0€/m¹ (por jo më pak se 50€), inspektori i shërbimeve publike ndëshkon personin fizik ose juridik, për shkeljen e dispozitave të nenit 14 (par. 14.20.2), përkatësisht personi/subjekti, i cili shtrinë kablllo në shtyllat e ndriçimit publik pa leje nga DSHPE.

22.8.1. Me gjobë mandatore në shumë prej 2€/m¹ për zonën urbane, 1.5€/m¹ për zonën periferike dhe 0.75€/m¹ për zonat tjera (por jo më pak se 50€), inspektori i shërbimeve publike ndëshkon personin fizik ose juridik, për mos vendosje në mënyrë të rregullt sipas standarteve të kabllove elektrike, internetit dhe të ngjajshme nëpër shtylla elektrike dhe të ndriqimit publik.

22.9. Me gjobë mandatore në shumë prej 100€ deri në 500€, inspektori i mjedisit ndëshkon personin fizik ose juridik, për shkeljen e dispozitave të nenit 14 (par. 14.22), përkatësisht ndëshkon personin/subjektin, i cili ka ndërtuar objektin ose ka filluar ndërtimin e objektit pa Leje Mjedisore Komunale, për të cilin objekt kërkohet një leje e tillë sipas UA-MMPH nr. 01/2017

22.10. Me gjobë mandatore në shumë prej 70€, inspektori i mjedisit ndëshkon personin fizik, ndërsa subjektin afarist në shumë prej 500€ për shkeljen e dispozitave të nenit 14 (par. 14.20.5), përkatësisht, ndëshkohet personi fizik ose subjekti afarist i cili gjeneron mbeturina dhe nuk lidh kontratë me kompanitë e licencuara për heqjen e mbeturinave (nuk hynë në sistemin për menaxhimin e mbeturinave).

22.11. Me gjobë mandatore në shumë prej 50€ deri në 500€, inspektori i shërbimeve publike ndëshkon personin fizik ose juridik, për shkeljen e dispozitave të nenit 16 (par. 16.1, 16.2, 16.3, 16.4, 16.5, 16.6, 16.7, 16.8, 16.9, 16.17), përkatësisht ndëshkohet personi/subjekti, i cili pa leje nga DPUMM, vendos automjete/makinat lëvizëse të cekura në këtë paragraf.

22.12. Me gjobë mandatore në shumë prej 50€ deri në 200€, inspektori i tregut, ndëshkon personin fizik ose juridik, për shkeljen e dispozitave të nenit 16 (par. 16.10), përkatësisht ndëshkohet personi/subjekti, i cili pa leje nga DPUMM, vendos/ekspozon produktet në hapësirë komunale para biznesit të tij.

22.13. Me gjobë mandatore në shumë prej 100 € deri në 300€, inspektori i tregut, ndëshkon personin juridik, për shkeljen e dispozitave të nenit 13 (par. 13.1), përkatësisht ndëshkohet personi/subjekti, i cili nuk posedon lejen për ushtrim të veprimtarisë afariste ose nuk posedon leje valide për ushtrim të veprimtarisë biznesore.

22.14. Me gjobë mandatore në shumë prej 70€ per person fizik dhe 500 - 1000€ per person juridik, inspektori i mjedisit ndëshkon atë i cili derdh ujërat e zeza në hapësira publike në vend banim, në sipërfaqen e rrugës, në brezin rrugor, në kultura bujqësore. Ndëshkimi duhet të jetë më i lartë në raste kur rrjeti i ujërave të zeza është në afërsi e nuk është kyçur.

22.15. Me gjobë mandatore në shumë prej 50€ deri në 500€, inspektori i shërbimeve publike apo personi i autorizuar nga KUR Prishtina, ndëshkon personin fizik ose juridik i cili dëmton rrjetin e ujësjellësit dhe nuk e sanon dëmin e shkaktuar apo në çfarëdo mënyrë ndikon në humbjen ujit.

22.16. Me gjobë mandatore në shumë prej 100€ deri në 500€, inspektori i komunikacionit, në varësi prej vlerës së dëmit, ndëshkon personin fizik ose juridik i cili dëmton shenjat e komunikacionit, shenjat e emërtimit të rrugëve, heq apo dëmton mbrojtëset e urës dhe pahit elastike të rrugës. Në rast të aksidentit, personi është i obliguar të riparojë vet dëmin ose të paguaj tarifën e dëmit të shkaktuar sipas vlerës së tregut të zyrtari për transport lokal në DSHPE. Nëse nuk dihet personi që ka shkaktuar dëmin, zyrtari për transport lokal është i obliguar që të parqet rastin në stacionin policor në Drenas për veprën "Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë" nga neni 321 i KP.

22.17. Me gjobë mandatorë në shumë prej 100€ deri në 1000€, inspektori i shërbimeve publike, në varësi prej vlerës së dëmit, ndëshkon personin fizik ose juridik i cili dëmton varrezat, lapidarët, pllakat përkujtimore, rrethojën e varrezave apo çfarëdo pjese të varrezave, përfshirë zjarrëvënje. Në raste të tilla personi përveç gjobës është i obliguar të riparojë vetë dëmin ose të paguaj tarifën e dëmit të shkaktuar sipas vlerës së tregut në DSHPE. Nëse nuk dihet personi që ka shkaktuar dëmin, DSHPE-ja është e obliguar që të parqet rastin në stacionin policor në Drenas, për veprën “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë” nga neni 321 i KP.

22.18. Me gjobë mandatore në shumë prej 100€ deri në 1000€, inspektori i shërbimeve publike, (në varësi prej vlerës së dëmit), ndëshkon personin fizik ose juridik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 17 të rregullorës dhe jo vetëm, por dëmton rrugën apo pjesët e saj, përkatësisht personi i cili pret rrugën e asfaltuar, depërton rrugën e asfaltuar, vendos pengesa në rrugë, mbyll apo ndërhyrje në kanalën kullues të rrugës, mbyll apo dëmton pusetat apo kapakët e tyre, mbyll kanalën kullues të rrugës më rastin e ndërtimit të rrugës për kyçe në rrugë, gjatë punimeve apo ndërhyrjes në brezin rrugor drejton ujërat atmosferike në rrugë të asfaltuar dhe dëme të ngjashme në rrugë dhe pjesë të saj të përcaktuara sipas ligjit për rrugët, nuk bënë pastrimin e hyrjeve private (para shtëpive dhe lokaleve). Në raste të tilla personi përveç gjobës është i obliguar të riparojë vetë dëmin ose të paguaj tarifën e dëmit të shkaktuar sipas vlerës së tregut tek zyrtari për transport lokal në DSHPE. Nëse, nuk dihet personi që ka shkaktuar dëmin, zyrtari për transport lokal në DSHPE është i obliguar që të parqet rastin në stacionin policor në Drenas, për veprën “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë” nga neni 321 i KP.

22.19. Me gjobë mandatore në shumë prej 100€ deri në 2000€, inspektori i tregut, ndëshkon personin përgjegjës i cili nga pakujdesia ofron për shitje sasi të vogël të produkteve ushqimore dhe jo ushqimore me afat të skaduar të përdorimit. Për rastin e sasisë së madhe të produkteve ushqimore dhe jo ushqimore me afat të skaduar, veçanërisht kur produktet më afat të skaduar ofrohen qëllimisht ose përsëritet, inspektori i tregut është i obliguar që ndëshkimin ta bëjë sipas ligjit për ushqim, ndërsa në raste më të rënda, të hapet rast në stacionin policor për veprën “Prodhi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimorë” nga neni 261 i KP.

22.20. Me gjobë mandatore në shumë prej 100€ deri 500€, inspektori i mjedisit ndëshkon personin fizik apo subjektin afarist i cili emiton muzikë apo çfarëdo lloji zhurme më tonë të lartë dhe më këtë prish qetësinë në vende publike.

22.21. Me gjobë prej 100€ deri 500€, inspektori i tokës bujqësore dënon personin fizik ndërsa me gjobë 400€ deri 1000€ dënon personi juridik i cili bënë ndërrimin e destinimit të Tokës Bujqësore në atë Ndërtimore (të fort) pa pëlqim të organit kompetent.

22.22. Me gjobë prej 200€ - 400 €, inspektori i tokës bujqësore dënon personin fizik ndërsa me gjobë prej 500€- 800 € dënon personin juridik i cili e shfrytëzon tokën bujqësore për qëllime jo bujqësore me destinim të përkohshëm pa pëlqim të organit kompetent për bujqësi.

22.23. Me gjobë prej 200€ - 400 €, inspektori i tokës bujqësore dënon personin fizik ndërsa me gjobë prej 300€- 1000 € dënon personin juridik në rastet e mbetjeve të trungjeve apo mbetjeve të tjera gjate punimeve nga persona apo operator të ndryshëm në Tokën Bujqësore.

22.24. Me gjobë prej 100€ - 300 €, inspektori i tokës bujqësore dënon personin fizik ndërsa me gjobë prej 400€- 800 € dënon personin juridik, nëse gjate inspektimit në Barnatore Bujqësore hasim në farëra të perimeve apo artikujt të tjerë pa afat .

22.25. Me gjobë jo më pak se 300€ dhe jo më shumë se 1000€, inspektori i tokës bujqësore dënon personin juridik nëse:

22.25.1. nuk e bën pasurimin e miellit në pajtim me nenin 9 të ligjit bazik dhe tregton miell pa afat,

22.25.2. paketimi i miellit të pasuruar nuk i përmban informatat e përcaktuara sipas nenit 10, paragrafët 3 dhe 4 të ligjit bazik;

22.25.3. nuk zbaton kriteret për cilësi dhe siguri të miellit të pasuruar në pajtim me nenin 11 të ligjit bazik.

22.26. Me gjobë prej 100 € - 500 €, inspektori i tokës bujqësore dënon personin fizik ndërsa prej 300€- 1000 € dënon personin juridik nëse: vendosen në treg PMB (produkte për mbrojtje të bimëve) jashtë listës së PMB-ve të lejuara nga Ministria dhe vendosen në treg PMB me afat të skaduar.

22.27. Me gjobë prej 300€ deri në 1000€, inspektori i tokës bujqësore dënon personin juridik nëse tregton varietete të cilat nuk janë përfshirë në Listën e Farërave të Kosovës në kundërshtim me nenin 8, paragrafi 15 të ligjit bazik, dhe kur etiketimi i paketimeve të farës bëhet në kundërshtim me nenin 14 të ligjit bazik.

22.28. Me gjobë mandatore prej 200€ deri 500€, inspektori i mjedisit dënon personin fizik apo juridik, i cili bënë ndotje të pa kontrolluar të ajrit, si pasojë e ushtrimit të veprimtarisë së tij ekonomike, apo përdorimit të pa kontrolluar të lëndëve djegëse për ngrohje.

22.29. Me gjobë mandatore prej 100€ deri 200€, inspektori i shërbimeve publike dënon personin fizik apo juridik, i cili nuk bënë prerjen-krositjen e bimëve-pemëve në parcelën e tij dhe si pasojë pengon dhe vështirëson komunikacionin.

22.30. Me gjobë mandatore prej 100€ deri 200€, inspektori i mjedisit dënon personin fizik i cili bënë djegien e hamullorëve, apo mbetjeve organike të kulturave bujqësore.

Nen i 23

Ndëshkimet kundërvajtës:

Të neni 29 i Ligjit për Kundërvajtje nr. 05/L-087 i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 33 me datë 08 shtator 2016 parashihet sanksionimi kundërvajtës me gjobë

Me aktin e Kuvendit të Komunës – Rregulloren për taksa tarifa ngarkesa dhe gjoba të Komunës së Gllogocit sanksioni kundërvajtës mund të përcaktohet dhe atë:(minimumi dhe maksimumi)

- 23.1 Për personin fizik dhe personin përgjegjës të personit juridik nuk mund të jetë me pak se njëzet (20) euro, dhe jo me shumë se njëmijë (1.000) euro,
-
- 23.2 Për personin fizik që ushtron biznes individual nuk mund të jetë me pak se pesëdhjetë (50) euro, dhe jo me shumë se tremijë (3.000) euro,
-
- 23.3 Për personin juridik nuk mund të jetë me pak se njëqindpesëdhjetë (150) euro, dhe jo me shumë se dhjetëmijë (10.000) euro.

Përfshihet nga paragrafi 24.1,2 dhe 3 i këtij neni, për kundërvajtjet e lehta mund të parashihet sanksioni kundërvajtës me gjobë në shumën e përcaktuar dhe atë:

-23.4 Për personin fizik dhe personin përgjegjës të personit juridik nuk mund të jetë me pak se dhjetë (10) euro, dhe jo me shumë se njëqind (100) euro,

- 23.5 Për personin fizik që ushtron biznes individual nuk mund të jetë me pak se tridhjetë (30) euro, dhe jo me shumë se dyqindpesëdhjetë (250) euro,

- 23.6 Për personin juridik nuk mund të jetë me pak se njëqind (100) euro dhe jo me shumë se njëmijepesëqind (1.500) euro.

Arsyeshmëria për bërjen e ndryshim plotësimit të kësaj rregulloreje është plotësimi i sajë me tarifën, taksat, ngarkesat dhe gjobat të cilat hyjnë nga Udhëzimet administrative të AKK në Prishtinë, pastaj ndryshimet e bëra edhe nga Drejtoratet tjera në nivel komunal, Gjithashtu edhe harmonizimi i kësaj rregulloreje me Ligjin për Kundërvajtje nr. 05/L-087 i shpallur në Gazetën zyrtare nr. 33/2016.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 24

Kjo Rregullore Komunale për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha miratohet në Kuvendin (Asambleenë) e Komunës së Gllogocit dhe licencohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në Prishtinë.

Neni 25

Kjo Rregullore mund të ndryshohet me procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gllogocit.

Neni 26

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja e Komunës së Gllogocit për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha komunale nr. 12 Nr.400-16587 të dt. 27.05.2020, si dhe shfuqizohet nen 13.6, dhe neni 13.5.5, i Plotësim ndryshimit të Rregullores Nr. 12.Nr. 400-16587 të dt; 27.05.2023.

Neni 27

Për zbatimin e kësaj Rregullorëje kujdeset: Kryetari i Komunës në bashkpunim me Drejtoritë përkatëse.

Neni 28

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryetari i Komunës


Ramiz Lladrovci



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT

02- NR. 020-51233

Drenas me : 16 10 2023



Komisioni për plotësim ndryshimin e Rregullorës për Taksa, Tarifa, ngarkesa dhe Gjoba i themeluar me dt: 31.08.2022 dhe nr: 020/04-46362 nxjerrë këtë:

R A P O R T

**PËR DRAFT-PROPOZIMI PËR NDRYSHIM-PLOTËSIMIN E RREGULLORËS PËR
TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA**

Me këtë raport Komisioni e dëshmon që ka plotësuar të gjitha kërkesat me të cilat është ngarkuar nga vendimi për formimin e komisionit për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, me nr: 02/202/04/46362 të dt: 31.08.2022 si në vijim:

- Komisioni ka bërë propozim-plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba duke i respektuar procedurat e parapara ligjore.
- Komisioni për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, ka kryer punën e tyre me profesionalizëm të lartë dhe përkushtim.

1. Violeta Baleci - kryetare

2. Arjanit Balaj - anëtar

3. Besart Bajrami - anëtar

4. Valentina Lekë - anëtare

5. Mehedin Salihu - anëtar

6. Drin Halilaj - anëtar dhe

7. Sulltane Mulaj - anëtare

13.10.2023 Drenas